

Kompania: Albimi Sh.p.k

Titulli i vendit të punës: Punë Praktike

Orari i punës: Orar të plotë

Kohëzgjatja e praktikës: 3 muaj me pagesë me mundësi të punësimit në kompani pas punës praktike

Punë praktike

Rreth Kompanisë

Kompania Albimi sh.p.k ofron mundësi për punë praktike me pagesë për **pesë (5)** praktikantë. Aplikuesit duhet të jenë nga komuna e **Vitisë, Hanit të Elezit, Kaçanikut, apo Gjilanit.**

Puna praktike ofrohet në kuadër të bashkëpunimit të Programit “Trajnim në Punë”

Rreth Programit “Trajnim në Punë”

Programi “Trajnim në Punë” ka për qëllim punësimin e të rinjve dhe ofrimin e zhvillimit të shkathësive tek të rinjt. Ky program është financuar nga “Fuqizimi i Sektorit Privat” (Empower Private Sector) nga Populli Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), si dhe zbatuar nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës (KPK).

Kandidatët duhet të jenë:

- Të moshës ndërmjet 18 dhe 35 vjeç;
- Të papunë (të dëshmohet përmes regjistrimit në qendrat e punësimit);
- Qytetarë me vendbanim në komunën e [ceke komunën];

Vendi: Rr. Lidhja e Prizrenit p.n.60000 Gjilan

Kohëzgjatja:

• Trajnimi do të jetë me pagesë dhe do të zgjasë tre (3) muaj, me mundësi të punësimit në kompani pas punës praktike.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Albimi Sh.p.k ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës. Kandidatët për punë praktike duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Aplikacionin e plotësuar (I obliguar)
- CV-në (Opsionale)

Nëse kandidati e kalon me sukses procesin e intervistimit, para se ti bëhet oferta ai/ajo duhet të prezanton këto dokumente:

- Vërtetim nga zyra komunale për punësim (dëshmi si i/e papunë)
- Çertifikatën e Lindjes (dëshmi e vendëbanimit)

Gjatë vlerësimit të aplikacioneve prioritet do të kenë:

- Të papunët afatgjatë (të papunë të paktën një vit);
- Të papunët pa përvojë pune paraprake;
- Të rinjtë nga familjet pa të hyra mujore (pjesë e skemave sociale) apo me të hyra të ulëta mujore;
- Të rinjtë nga familjet me numër të madh të anëtarëve;
- Të rinjtë nga zonat rurale.

Si të aplikoni

Për të aplikuar dërgoni me email aplikacionin e plotësuar në e-mail adresën:

doruntina@albimi.com si dhe në email info@klubiprodhuesve.org me subjektin: **Aplikim për punë praktike**. Aplikacionin e plotësuar mund ta dorëzoni edhe **personalisht** në këtë adresë: Rr. Lidhja e Prizrenit p.n.60000 Gjilan

Aplikimi është i hapur deri me 16.03.2019 ora 16:00

APLIKACIONI

Projekti: "Trajnimi në Vendin e Punës"

Emri dhe Mbiemri: _____

Data e lindjes: _____

Gjinia: _____

Adresa e vendbanimit: _____

Komuna: _____

Nr. Personal i letërnjoftimit: _____

Numri i telefonit: _____

E-mail: _____

1. Kombësia juaj?

- a) Shqiptar
- b) Serb
- c) Rom/Ashkali/Egjiptian
- d) Turk
- e) Tjetër (specifiko) _____

2. Sa anëtarë të familjes jeni?

3. A jeni në skemën sociale? Po / Jo

4. Sa anëtarë të familjes janë të punësuar? _____

5. Sa janë mesatarisht të hyrat mujore në familjen tuaj dhe nga çfarë burimesh vijnë ato?

6. Niveli i shkollimit tuaj/ profesioni juaj?

7. A jeni te regjistruar si i papune ne qendrat e punesimit, aktualisht apo ne te kaluaren?

8. A keni pasur pervoje pune paraprake dhe nese po ju lutem listoni me poshte duke dhene informata konkrete lidhur me kompanine, pergjegjesite tuaja, si dhe kohen e angazhimit.

9. A jeni perfitues i ndonje projekti zhvillimor ne te kaluaren, qofte ne forme te grantit, trajnimit, vendosjes ne kompani, apo forma te tjera?

Nënshkrimi i aplikuesit:

Data: